



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -
MinistarstvoIndustrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV(MINT) Nr. 02/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr.
06/2023 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E REGJISTRIMIT DHE
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYAVE TURISTIK**

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 29 paragrafi 2, nenit 30, dhe nenit 32 paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-074 për Turizmin (Gazeta Zyrtare nr. 15, 13.06.2022), të nenit 39 paragrafi 2, të Ligjit nr. 08/L-074 për Turizmin (Gazeta Zyrtare nr. 15,13.06.2022), nenit 11, paragrafit 1. nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shtojca 12 e Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafi 6 të Rregullores e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15/ 12.09.2011) nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 02/2024 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 06/2023 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E REGJISTRIMIT DHE USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYVE TURISTIK

Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit administrativ (MINT) nr. 06/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfysve turistik.

Neni 2

1. Fshihet dhe riformulohet paragrafi 3 i nenit 3 i udhëzimit bazë si dhe shtohet paragrafi 4 me tekstin si në vijim :

3. Udhërrëfyesi turistik ushtron veprimtarinë si në vijim:

3.1. Udhërrëfyesi turistik kombëtar- personi i cili mund të udhëheq në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

3.2. Udhërrëfyesi turistik lokal - personi i cili mund të udhëheq vetëm në një ose më shumë komuna brenda territorit të Republikës së Kosovës.

3.3. Udhërrëfyesi i një fushe specifike personi i cili udhëheq shërbimet e udhëheqjes së aktiviteteve të tilla si:

3.3.1 Hiking dhe trekking;

3.3.2 Ski touring dhe snow shoeing;

3.3.3 Biking tours;

3.3.4 Off roading;

3.3.5 Kajaking ;

3.4.6 Parashutizmi;

3.5.7 Ngjitja;

3.6.8 Kalërimi;

3.7.9 Rrëshqitja në litar.

4. Të gjithë udhërrëfyesit turistik të cilët angazhohen te agjencitë e udhëtimit duhet të jene të regjistruar dhe të paisur me ID kartelë sipas procedurave dhe kriterëve të parapra në Udhëzimin Administrativ përkatës për kushtet, kriteret dhe procedurat e regjstrimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfyesve turistik dhe me Ligjin nr. 08/L-074 për Turizmin.

Neni 3

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2.2 i neni 8 të udhëzimit bazë me tekstin si në vijim:

2.2. dy përfaqësues nga ministria, prej tyre njëri të jetë jurist.

Neni 4

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 3 i nenit 9, të udhëzimit bazë me tekstin si në vijim:

3. Komisioni për mbledhjet e tij mban procesverbal mbi shqyrtimin e kërkesave dhe rekomadon për cdo kërkesë.

Neni 5

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2 i nenit 14 të udhëzimit bazë me tekstin si në vijim:

2. Gjatë kësaj periudhe kalimtare, Ministria do të pranoj edhe dëshmi të kualifikimeve dhe trajnimeve tjera përkatëse lidhur me ushtrimin e profesionit të udhërrëfyesit turistik, si dhe përvojën e punës së paku 2 vite.

Neni 6

1. Ndryshohet dhe plotësohet shtojca 1 e Udhëzimit bazë, me tekstin si në vijim:

1.1. Dëshminë me të cilën vërtetohet përfundimi i një programi kualifikimi për udhërrëfyes turistik/ dëshmi të kualifikimeve dhe trajnimeve tjera përkatëse lidhur me ushtrimin e profesionit të udhërrëfyesit turistik, si dhe përvojë e punës së paku 2 vite.

Neni 7

Ky udhëzim është pjese përbërse e Udhëzimit administrativ (MINT) nr. 06/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e regjstrimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfyesve turistik

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë(7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Ministre

28 Shkurt 2024